



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**  
Njësia e prokurimit

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.,

Tiranë 23/07/2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Blerje Kancelarie për vitin 2024”;**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**MALLRA, Kodet CVP: artikuj kancelarie,**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 4,436,652 (Katër milion e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa tvsh. . **Fonde të tjera;**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3, në masën 2% të vlerës së përlogaritur të kontratës në një nga format e parashikuara në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” konform nenit 83, perkatesisht në vlerën prej 88.733 (Tetëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre ) lek pa tvsh.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

## **2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit (2021,2022,2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit qe prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros se percaktuar dhe te kerkuar nga autoriteti kontraktor kerkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike te operatorit ekonomik si dhe per të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne legjislacioni tatimor ku xhiroja dhe bilancet kane si afat perfundimtar per tu mbyllur dhe dorezuar prane organeve tatimore maksimumi deri ne fund te muajit Prill te vitit qe vjen.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar sipas ligjit nr.8438 date 28.12.1998 i ndryshuar. (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

## **3 Kapaciteti teknik:**

**3.1** Operatori ekonomik, duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparëshme, të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit ( 2021-2022-2023 ) nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit.

Realizimi i furnizimeve të ngjashme, duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë:

---



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e shërbimeve ose faturat tatimore të shitjes;
- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të jenë shënuar datat, shumat dhe sasitë e shërbimeve të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

---

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve per procedurën e hapur te thjeshtuar eshte percaktuar se vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

**3.2.Operatori Ekonomik të paraqesë çertifikatë të vlefshme me objekt të njëjtë me objektin e prokurimit si më poshtë:**

Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me **ISO 9001:2015 (të vlefshme) – Sistemet e menaxhimit të cilësisë (ose ekuivalente me të)**. Certifikata që do të paraqitet kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Argumentimi: Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Certifikata e mësipërme duhet të jenë në gjuhën shqip ose të jenë të përkthyer në shqip, si dhe origjinale ose të njëhësuara me origjinalin (kopje të noterizuar). Çertifikatat duhet të jenë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues*

---



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ne rastet kur oferta dorezohet nga një BO, operatorët duhet të disponojnë certifikatat e kerkuara në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë që mallrat janë në përputhje me specifikimet teknike, janë të reja të pa përdorura.

*Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.*

3.4 Operatori ekonomik për artikullin letër A4 duhet të paraqesë:

- a) Skedë teknike nga prodhuesi ose distributori për produktin letër A4 sipas specifikimeve teknike të kerkuara në dokumentat e tenderit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**3.5** Për vlerësimin e ofertës teknike, Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë pranë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në Autoritetin Kontraktor mostrat e produkteve që ato ofrojnë sipas listës së artikujve të kërkuar në këtë procedurë prokurimi ditën dhe orën e zhvillimit të tenderit, të shoqëruar me autorizim dhe me procesverbalin e dorëzimit të artikujve. Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në

---



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

#### TABELA E MOSTRAVE QE DO TE DORZOHEN

Nr	Artikujt	Specifikimet Teknike	Njësia/copë	Sasia
1	Letër A4 80 gr/m2	Pesha baze (min 78g/m2 max 82g/m2) Trashësi microns (min 98 max 108) CIE e Bardhësisë (min 144 max 150) Patejdukshmeria (min 90%) Ashpersia ml/min (min 150 max 300)	rismë	1

Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të paraqesë autorizimin përkatës për paraqitjen e tyre si dhe një shkresë të vëlosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf ose kuti.

Gjithashtu mosdorëzimi i mostres në kohë përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik ofertues.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të kërkuara.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



### Specifikimet teknike të tonerave për printer dhe fotokopje

Nr	Artikujt	Specifikimet Teknike	Njësia/ copë	Sasia
1	Letër A4 80 gr/m2	Pesha baze (min 78g/m2 max 82g/m2) Trashësi microns (min 98 max 108) CIE e Bardhësisë (min 144 max 150) Patejdukshmeria (min 90%) Ashpersia ml/min (min 150 max 300)	rismë	5000
2	Dosje kartoni me lidhëse me lëmbë		copë	1085
3	Dosje kartoni me llustër me llastik 1.5 cm	Dosje kartoni me llustër dhe llastik 1.5 cm duhet të jenë me karton pesha 450gr/m2 dhe me llustër.	copë	1985
4	Dosje të mëdha buton me permasa përafërsisht. 100mm x 350mm x 250mm	Materiali karton	copë	506
5	Dosje të mëdha buton me permasa përafërsisht. 120mm x 350mm x 250mm	Materiali karton	copë	620
6	Dosje të mëdha buton me permasa përafërsisht. 150mm x 350mm x 250mm	Materiali karton	copë	572
7	Zarf 23 cm x 33 cm		copë	1220
8	Zarfa plastik me vrima	Zarfat plastikë me vrima duhet të jenë me trashësi 100 micron. Pakoja me 100 cope.	pako/100 flete	93
9	Stilolapsa të thjeshtë	Stilolapsat e thjeshtë duhet të jenë me suste dhe me trashësi 1mm. Trupi i tyre duhet të jetë më ngjyra të ndryshme.	copë	1215



REPUBLICA E SHQIPËRISË



10	Tregues 4 ngjyrësh për ndarje fletësh	Treguesit 4 ngjyrësh për ndarjen e fletëve duhet të jenë plastikë, me 4 ngjyra të ndryshme. Çdonjëra nga ngjyrat duhet të ketë 25 fije secila. Pako me 4 cope.	pako	188
11	Blllok porosish 38mm x 51mm	Bllloqet për porosi duhet të jenë me përmasa minimumi 38x51mm, me ngjyra të ndryshme dhe minimum 100 fije	copë	71
12	Blllok porosish 75mm x 125mm	Bllloqet për porosi duhet të jenë me përmasa minimumi 75x125mm, me ngjyra të ndryshme dhe minimum 100 fije	copë	79
13	Kapak plastik për lidhje	Kapakët plastikë për lidhje dokumentash duhet të jenë me trashësi 220 micron.	copë	385
14	Kapëse me veshë 25 mm		kuti/12 cope	251
15	Kapëse me veshë 51 mm		kuti/12 cope	288
16	Makinë kapëse 24/6 25fl metal	Makina kapëse 24/6 për lidhje dokumentash duhet te jete me trup metalik, e madhe në formë pince dhe duhet të kapi deri në 25 fletë.	copë	77
17	Mouse USB laser	Mouse USB duhet të jetë me laser, kabëll usb-je	copë	62
18	Makinë llogaritëse me 12 shifra të mëdha 16 x 21 cm	Makina llogaritëse duhet të jetë me 12 shifra të mëdha me përmasa min 16x21 cm, financiare dhe elektronike.	copë	35
19	Kapak kartoni për lidhje 230/270 gr	Kapakë kartoni për lidhje dokumentash duhet të jetë me ngjyrë pana dhe peshë 270gr.	copë	425
20	Blllok mbledhjesh me kapak lëkure	Bllloqe për mbledhje duhet të jenë prej lëkure, format A4 dhe me vija.	copë	72
21	Makina të vogla 10	Makinat e vogla 10 duhet të jenë me trup metalik të mëdha në formë pince.	copë	73
22	Tela makine 10		kuti	362





23	Makine lidhje me spirale me kapacitet 450 fletë	Makina për lidhjen e dokumentave me spirale, duhet të jetë metalike dhe me kapacitet lidhje deri ne 450 flete njëherësh.	copë	7
24	Lapsa		copë	400
25	Evidentues ( 4 ngjyrësh)		pako/4 cope	264
26	Tela makine 24/6		kuti	370
27	Kapese aktesh N 3 (28 mm)		kuti	257
28	Dosje me mekanizem (8 cm) me kuti	Dosjet me mekanizem (8 cm) me kuti dhe me lartesi maksimale	copë	480
29	Zarfa 11 x 23	Zarfat duhet të jenë me përmasa 11 x 23cm dhe me peshë 90gr.	copë	1255
30	Shina për lidhje dokumentash 6		copë	370
31	Shina për lidhje dokumentash 9		copë	360
32	Flesh 32 GB	Flesh 32GB duhet të ketë madhesi mesatare dhe shpejtesi minimumi 3.0	copë	118
33	Dosje me zarfa plastik (60zf)	Dosjet me zarfa plastik (60zf) duhet të përmbajnë 60 zarfa me trashesi 60 micron te zarfit.	copë	349
34	Tela makine 23/10		kuti	223
35	Stilolapsa ball point (maja me sferë), tratto 3 ose ekuivalent	Duhet të jenë me suste, trup trekendor plastik ngjyre blu dhe me gomine tek pjesa e gishtave, me kapese xhepi. Ngjyre blu.	copë	371
36	Stilolapsa rapid (Sch One Business) ose ekuivalent	Stilolapsa rapid duhet të jenë me trup te gomuar dhe me majë 0.6 mm, One Business ngjyre blu.	copë	385
37	HDD USB 3.0 i jashtem 500 GB		copë	30
38	HDD USB 3.0 i jashtem 1 TB		copë	35
39	Patch ethernet network cables 1.5 m		copë	33
40	Patch ethernet network cables 3 m		copë	36
41	Patch ethernet network cables 5 m		copë	33
42	Patch ethernet network cables 10 m		copë	34
43	CD me kapak		copë	174





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



### ***Argumentimi i specifikimeve teknike***

*Argumentimi: Specifikimet Teknike të mësipërme janë në përputhje me nenet: Neni 4, pika 38/b të LPP, si dhe nenit 40, pika 2; 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.  
Theksojmë se ‘Specifikimet Teknike’ i shërbejnë AK për të patur garanci se malli i ofruar do të jetë në parametrat dhe në cilësinë e duhur.*

## **NJESIA E PROKURIMIT**

**Arian Karroçi   Ergan Dollani   Fabiola Ribaj**

---